

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

# PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2024



[www.nbrm.mk](http://www.nbrm.mk)



## QËLLIME STRATEGJIKE

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

|                                                                                                                                                           |    |                                                                                                            |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Misioni, vizioni, vlerat                                                                                                                                  | 1. | QS 7 – Edukimi dhe përfshirje financiare                                                                   | 10. |
| Hyrje                                                                                                                                                     | 2. | QS 8 - Vetëdijësimi i rritur për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër | 11. |
| Aktivitetet programore - Qëllime strategjike                                                                                                              | 3. | QS 9 - Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore                                       | 12. |
| QS 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare                                                                                  | 4. | Aktivitete programore - Kapacitete institucionale                                                          | 13. |
| QS 2– Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar                                                                   | 5. | KI 1 - Integritet dhe besim në njësinë monetare kombëtare                                                  | 14. |
| QS 3– Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurta, inovative dhe efikase                        | 6. | KI 2 - Burime Njerëzore                                                                                    | 15. |
| QS 4– Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optima të rezervave të valutave të huaja në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit | 7. | KI 3 - Sistem informativ                                                                                   | 16. |
| QS 5 - Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore                                                                               | 8. | KI 4 - Të dhëna statistikore                                                                               | 17. |
| QS 6 – Rritje e transparencës dhe llogaridhënies                                                                                                          | 9. | KI 5 - Veprimtaria hulumtuese                                                                              | 18. |

## QËLLIME STRATEGJIKE

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

*„Banka qendrore e cila me vendime fleksibile, të menduar në mënyrën e duhur dhe në kohë, në një kohë të ndryshimeve të shpejta dhe transformimit digjital, kontribuon për një standard më të lartë të jetës së qytetarëve përmes krijimit të mjedisi të për zhvillim që qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik“*

## MISIONI



Me përmbushjen e mandatit dhe kompetencave të saj kontribuon drejt ruajtjes së stabilitetit çmimor dhe financiar për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe përfshirje dhe standard më të lartë të jetës për qytetarët. Kontribuon në ruajtjen e sistemit financiar të qëndrueshëm, konkurrues dhe të orientuar nga tregu dhe fleksibël ndaj ndryshimeve të shpejta mjedisore, e cila funksionon në interes më të mirë të mundshëm për konsumatorët dhe gjithë ekonominë.

## VIZIONI



Vizioni i Bankës Popullore është të njihet si institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional, inovativ dhe transparent e cila gëzon besim dhe kredibilitet të lartë në publik.


## VLERAT



Banka Popullore funksionon në pajtim me këto parime dhe vlera: cilësi, integritet, besnikëri, transparencë, lidhshmëri, inovacion, fleksibilitet, profesionalizëm dhe shpirt ekipor.


Vizioni, misioni dhe vlerat në kuadër të mandatit dhe kompetencave të saj realizohen përmes **aktiviteteve programore** që dalin nga qëllimet strategjike dhe kapacitetet institucionale të Bankës Popullore dhe realizohen gjatë gjithë vitit.

## QËLLIME STRATEGJIKE



Programi i punës përmban aktivitete programore për realizimin e Planit strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022 - 2024 përmes shënjesërimit optimal të burimeve të disponueshme drejt fushave prioritare, forcimin e kapaciteteve në të gjitha segmentet e punës, përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së punës dhe të mundësojë edhe vlerësimin e rezultateve dhe efektivitetin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra.


## KAPACITETE INSTITUCIONALE



Aktivitetet e programit zbatohen nëpërmjet proceseve të rregullta të punës dhe të projekteve të cilat mundësojnë hyrjen e ndryshimeve në punë në drejtim të rritjes së efikasitetit, cilësisë, transparencës dhe besueshmërisë, pajtueshmërisë me kërkesat e reja ligjore, rregulloret europiane, standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e Fondit Ndërkombëtar Monetar.

## QËLLIME STRATEGJIKE

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

**QËLLIMI STRATEGJIK 1**

Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare

**QËLLIMI STRATEGJIK 2**

Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar

**QËLLIMI STRATEGJIK 3**

Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurta, inovative dhe efikase

**QËLLIMI STRATEGJIK 4**

Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave devizore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit

**QËLLIMI STRATEGJIK 5**

Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore

**QËLLIMET STRATEGJIKE 6**

Rritje të transparencës dhe llogaridhënies

**QËLLIMI STRATEGJIK 7**

Edukim financiar dhe përfshirje

**QËLLIMI STRATEGJIK 8**

Vetëdijësimi i rritur për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër

**QËLLIMI STRATEGJIK 9**

Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare

Forcimi dhe përmirësimi i aftësive analitike, si dhe fuqizimi i kapaciteteve për analiza dhe projeksione makroekonomike do të jenë baza për menaxhimin e mëtejshëm të suksesshëm të politikës monetare. Prioritet për Bankën Popullore ende është stabiliteti i çmimeve dhe ruajtja e stabilitetit të kursit të denarit. Banka Popullore do të vazhdojë të menaxhojë likuiditetin e sistemit bankar duke përshtatur kornizën operative në pajtim me sfidat e jashtme dhe të brendshme.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Analizë të gjendjet makroekonomike në vend dhe hartim të projeksioneve makroekonomike



Përgatitja e analizave për qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe të jashtëm, kursin real të balancuar të këmbimit dhe transmetimin monetar



Kryerja e rregullt e operacioneve monetare dhe ruajtja e stabilitetit në tregun valutor të denarit



Harmonizimi i mëtejshëm i kornizës monetare për menaxhim më efikas të politikës monetare duke përmirësuar kanalin e transmetimit të normave të interesit dhe duke mbështetur procesin e denarizimit



Mbështetja e zhvillimit të tregut të brendshëm valutor dhe tregjeve të brendshme financiare

**Rezultatet e pritura:** Forcimi i kapaciteteve dhe avancimi i mjeteve për analiza makroekonomike dhe parashikimi dhe afrimi me praktikën më të mira të vendosura nga institucionet financiare ndërkombëtare. Ndryshime në kohë dhe të duhura në politikën monetare, mbajtje e kursit të këmbimit stabil të denarit dhe stabilitet i çmimeve në afat të mesëm.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 2 Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar

Banka Popullore, si autoritet mbikëqyrës që mbikëqyr bankat dhe bankat e kursimit, mbetet e palëkundur në angazhimin e saj për zbatimin e mbikëqyrjes efektive mikroprudenciale dhe makroprudenciale. Një nga qëllimet e Bankës Popullore është të ruajë besueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit bankar, i cili është rezistent ndaj rreziqeve të jashtme dhe të brendshme, të promovojë mbikëqyrjen jashtë vendit dhe në vend, si dhe aktivitetet që lidhen me krijimin e kushteve për zhvillimin e duhur të sektorit fintek. Vëmendje do t'i kushtohet forcimit të mëtejshëm të praktikave mbikëqyrëse në fushën e vlerësimit të rreziqeve që lidhen me ndryshimin e klimës.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Pajtueshmëria me rregulloren europiane, standardet ndërkombëtare dhe tendencat në fushën e rregullimit bankar



Vlerësime dhe analiza të rregullta të rreziqeve sistemike dhe marrja e duhur e masave makroprudenciale



Mbikëqyrja e lëvizjeve dhe rreziqeve në sistemin bankar dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj goditjeve duke kryer teste ndjeshmërie.



Fuqizimi i kapaciteteve të Bankës Popullore në lidhje me ndryshimet klimatike



Aktivitete të rregullta jashtë vendit, kryerja kontrollës mbikëqyrëse në terren dhe mbikëqyrjen e rrezikut të TI-së dhe sigurisë kibernetike



Zhvillimi i strategjisë mbikëqyrëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit



Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për mbështetjen e sektorit të fintekut

#### Rezultatet e pritura:

Sistemi bankar i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj rreziqeve të jashtme dhe të brendshme. Korniza rregulluese e cila mundëson sistem bankar tregtar dhe konkurues, në pajtim me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare më të mira.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 3 Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurta, inovative dhe efikase

Zbatimi aktiv i kuadrit të ri ligjor në sferën e pagesave, i cili mundëson futjen e teknologjive dhe inovacioneve të reja për të mbështetur pagesat për popullatën dhe sektorin e korporatave. Kryerja e mbikëqyrjes indirekte dhe direkte të sistemeve të pagesave për të mbështetur ekzekutimin e sigurt dhe efikas të pagesave dhe pajtueshmërinë e mëtejshme me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare në këtë fushë. Banka Popullore do të vazhdojë të ndërmarrë aktivitete për ruajtjen e besueshmërisë, stabilitetit dhe efikasitetit të shlyerjes së transaksioneve të lidhura me qëllim të zbatimit të politikës monetare dhe menaxhimit të rezervave valutore. Duke pasur parasysh se jetojmë në epokë të mjedisit digjital që kërkon risi të vazhdueshme financiare, Banka Popullore do të vazhdojë me analizat fillestare të mundësive, përparësive dhe rreziqeve të mundshme të emetimit të valutës digjitale, si formë digjitale e monedhës sonë sovrane, denarit.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Strategjia për zhvillimin e sistemit të pagesave RMV-së dhe zhvillimi dhe miratimi i planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë



Ndjekja e zbatimit të rregullores së re në fushën e shërbimeve pagesore dhe sistemeve pagesore



Projekte për zhvillim dhe përmirësim të zgjidhjeve aplikative në fushën e sistemeve pagesore dhe zhvillimit të shërbimeve pagesore



Përmirësimi i operacioneve në sfond në pajtim me standardet e Bankës Qendrore Europiane dhe forcimi i procedurave dhe sistemeve operacionale për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit



Pjesëmarrje në aktivitetet e Këshillit të bashkëpunimit rajonal

#### Rezultatet e pritura:

Rritje të sigurtisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemit pagesor, përfshirje më të madhe dhe mbrojtje më të mirë të përdoruesve të shërbimeve pagesore. Shfaqja e ofruesve të shërbimeve të ri në treg, siç janë institucionet pagesore, institucionet për para elektronike dhe operatorët e ri të sistemeve pagesore, si dhe rritjen e shkallës së digjitalizimit të shoqërisë maqedonase.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 4 – Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave devizore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit

Banka Popullore menaxhon me rezervat në valutë të huaj të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila është me interes kombëtar për mbarë ekonominë vendase. Në harmonizim me detyrat e saj ligjore, Banka Popullore synon të menaxhojë me efikasitet rezervat valutore, me balancë optimale ndërmjet parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga menaxhimi.


#### AKTIVITETET KRYESORE:




Menaxhim me rezervat valutore



Zbatimi i kornizës së vendosur me parashikime afatshkurta për lëvizjet e tregjeve financiare në bazë të treguesëve të përzgjedhur tregu/makroekonomi



Zgjerimi i fushës së zbatimit të modelit të ri biznesi në administrimin e rezervave valutore



Rishikimi i kuadrit për përcaktimin e kufijve të ekspozimit të rezervave valutore

**Rezultatet e pritura:** Menaxhimi efikas me rezervat valutore të Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë baraspeshës optimale mes parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga menaxhimi.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 5 – Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore

Banka Popullore ndjek dhe kontribuon në përcaktimin strategjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrim në institucionet evropiane. Edhe më tej do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në proceset e integrimit evropian duke kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha dokumenteve strategjike. Banka Popullore do të vazhdojë me harmonizimin e punës së saj dhe me zbatimin aktiv të rregulloreve, standardeve dhe praktikave evropiane.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Aktivitete lidhur me procesin e anëtarësimit të BPRMV-së në Sistemin European të Bankave Qendrore




Aktivitetet për zbatimin e reformave dhe rekomandimeve në lidhje me procesin e integrimit evropian sipas raporteve zyrtare nga institucionet e BE-së



Forcimi i kapaciteteve përmes shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit me bankat e tjera qendrore dhe institucionet ndërkombëtare



Dorëzimi i të dhënave të normave të ponderuara të interesit në BQE, sipas kërkesave të transmetimit të të dhënave



Pjesëmarrja në projektin IPA të DZS-së për tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve



Futja e sistemit të integruar të raportimit nga BPRMV-ja, bankat, kursimoret, për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse (ISIDORA)



Aktivitete për vendosjen e sistemit për udhëheqje, ruajtje, përpunim me të dhënat statistikore, krijimin e depos së të dhënave

#### Rezultatet e pritura:

Pajtueshmëria me ligjin e Bashkimit European (acquis communautaire) brenda kornizave në të cilat merr pjesë Banka Popullore. Avancimi i aftësive analitike, shkëmbimi i përvojave dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të Bankës Popullore.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMET STRATEGJIKE 6 - Rritje të transparencës dhe llogaridhënies

Banka Popullore përpiqet për përmirësim të vazhdueshëm të transparencës dhe llogaridhënies në punën e saj. Në kuadër të aktiviteteve për informimin e publikut, Banka Popullore do të përdor qasje të sistemuar në komunikim, e cila do të mundësojë disponueshmërinë dhe shpërndarjen në kohë të informatave dhe të dhënave të nevojshme, me arsyetim të duhur për masat e ndërmarra. Për forcim të kredibilitetit, vazhdon realizimi i Planit strategjik përmes ofrimit efikas dhe efektiv të aktiviteteve dhe projekteve të programit vjetor. Zbatimi i standardeve më të larta të transparencës gjatë raportimit financiar.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Komunikimi me publikun dhe thellimi i bashkëpunimit me median si hallka e parë e transmetimit të informacionit



Komunikimi dhe shkëmbimi i mendimeve me ekspertë dhe përfaqësues të komunitetit bankar qendror në fushën e politikës monetare dhe të sistemit financiar



Planifikimi Strategjik, përgatitja dhe zbatimi i Planit të ri strategjik për vitin 2025 - 2027



Publikimi i Raporteve financiare të BPRMV-së dhe mendimi nga revizori i jashtëm



Zbatim të rregullt dhe efikas të furnizimeve publike për shkak të funksionimit të papenguar



Edukimi muzeor dhe puna hulumtuese



Punë me fondin e bibliotekës, digjitalizimi i materialit arkivor me rëndësi historike

#### Rezultatet e pritura:

Informimi më i madh për qëllimet edhe detyrat e Bankës Popullore dhe realizimit të vizionit të njihet si institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional, inovativ dhe transparent e cila gëzon besim dhe kredibilitet të lartë në publik.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7


QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 7 Edukimi dhe përfshirja financiare

**Forcimi i edukimit financiar të popullatës, përmirësimi i shkallës së përfshirjes financiare dhe sigurimi i mbrojtjes adekuate të konsumatorëve janë fushat kryesore në të cilat Banka Popullore do të vazhdojë të punojë me përkushtim për të arritur këtë qëllim strategjik. Në qendër të vëmendjes të këtij qëllimi strategjik do të jetë zbatimi i Strategjisë për edukim financiar dhe përfshirje financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2025.**

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Edukimi financiar dhe organizimi i ngjarjeve për edukimin e publikut (Java Globale e Parasë, Ditët e edukimit financiar, Kuizi European i Parasë, Dita Botërore e Kursimeve dhe edukimi dhe përfshirja e grupeve vulnerabël në shoqëri)



Punëtori e dedikuar për gratë sipërmarrëse në fushën e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)



Aktivitetet e mëtejshme rreth shqyrtimit dhe harmonizimit të Propozim-ligjit për ombudsmanin financiar me rregulluesit tjera financiar



Zbatimin e kontrolleve në terren dhe hartimin e raporteve të rregullta për llojin e ankesave dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre nga ana e bankave dhe kursimoreve



Rishikimi dhe përmirësimi i legjislacionit ekzistues me qëllim forcimin e sistemit të mbrojtjes së konsumatorit në sistemin bankar

**Rezultatet e pritura:** Rritja e vetëdijësimit dhe edukimit financiar të popullsisë, përmirësimin e shkallës së përfshirjes financiare dhe forcimin e sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve.

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### QËLLIMI STRATEGJIK 8 - Vetëdijësimi i rritur për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër

Banka Popullore, si institucion me përgjegjësi shoqërore, do të vazhdojë të ndërmarrë hapa më konkretë për të menaxhuar në mënyrë aktive rreziqet e ndryshimeve klimatike, forcimi i elasticitetit dhe kapaciteteve të sistemit bankar për të menaxhuar rreziqet klimatike, por edhe për të rritur potencialin e tij për të mbështetur transformimin e gjelbër të ekonomisë. Gjithashtu, me synimin për të rritur ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike, Banka Popullore do t'i qaset përmbushjes së Planit afatmesëm të aktiviteteve të Bankës Popullore në fushën e menaxhimit të rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike për periudhën 2023 - 2025.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Mbikëqyrja e standardeve ndërkombëtare në fushën e rreziqeve nga ndryshimet klimatike dhe kuptimi i mundësisë së zbatimit të tyre në sistemin bankar




Mbikëqyrja e rreziqeve të ndryshimeve klimatike dhe kryerja e testimit të stresit për të vlerësuar elasticitetin e sistemit bankar



Rishikimi i parametrave për matjen e rrezikut të ndryshimeve klimatike në administrimin e rezervave valutore dhe efektin e investimeve në obligacione "të gjelbërta" në përmirësimin e mjedisit.



Shqyrtimi i mundësisë për të lënë mënjatë portofol të veçantë të obligacioneve të gjelbra



Kontribut në punën e rrjetit të sistemit financiar të gjelbër



Organizimi i konferencës për financat e gjelbra

#### Rezultatet e pritura:

Vetëdijësimi i rritur për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër dhe kushte më të mira jete të qytetarëve

## QËLLIME STRATEGJIKE

QS 1

QS 2

QS 3

QS 4

QS 5

QS 6

QS 7

QS 8

QS 9

### Qëllimi Strategjik 9 – Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore

Banka Popullore, si institucion me funksione dhe detyra me interes publik, do t'i përkushtohet menaxhimit të mëtutjeshëm efektiv të rrezikut në të gjitha segmentet e punës së saj me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike duke respektuar standardet më të larta për udhëheqje korporative. Do të vazhdohet me përmirësimin e mekanizmave për kontrollin e brendshëm të rrezikut, të forcohet besueshmëria e sistemit të informacionit dhe kapaciteti i menaxhimit të rrezikut ligjor, ruajtje e nivelit të lartë të pajtueshmërisë ligjore dhe etike, si dhe përmirësimi i mëtjshëm i masave të sigurisë dhe besueshmërisë gjatë punës. Janë paraparë edhe aktivitete për përmirësimin e procesit të planifikimit operativ, analizimit të pozitës financiare dhe bilancit të suksesit dhe realizimit të planit financiar, si dhe zbatimin e projektit të futjes së sistemit të integruar të kontabilitetit si mekanizëm për mbrojtje nga rreziqet e rritura në punë. Do të ndërmerren aktivitete për forcimin e qeverisjes korporative dhe pozitës kapitale të Bankës Popullore.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Udhëheqja me rreziqet operative dhe ngritjen e vetëdijësimit dhe kulturës së punonjësve të udhëheqin me rreziqet operative nga funksionimi i përditshëm



Realizimi i revizionit bazuar në rrezik që ofrojnë siguri të arsyeshme për menaxhimin e rreziqeve operacionale, sistemin e kontrolleve të brendshme dhe udhëheqjen e korporatës në Bankën Popullore.



Kontrolle periodike, këshillime dhe trajnime të rregullta për punonjësit, për drejtat dhe detyrimet e mbrojtjes së sistemit informativ, të dhënave personale dhe informacioneve të klasifikuara



Përditësim dhe testim të realizueshmërisë së planeve për vazhdueshmëri të proceseve kritike të punës në skenarë të krizës



Ndryshimet në politikat dhe rregullat e kontabilitetit në përputhje me ndryshimet e propozuara në kuadrin ligjor me qëllim të forcimit të qeverisjes së korporatës dhe pozicionit të kapitalit



Përmirësimi i pajtueshmërisë në nivel të BPRMV-së, identifikim dhe vlerësim të rreziqeve të mospajtueshmërisë



Zbatim të mëtjshëm të projektit dhe futjes së sistemit të integruar të kontabilitetit

#### Rezultatet e pritura:

Udhëheqje efektive me rreziqet në të gjitha segmentet e funksionimit për arsye të qëllimeve strategjike, për forcimin e masave kontrolluese dhe uljen e rreziqeve tjera, përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë të Bankës Popullore.

## QËLLIME STRATEGJIKE

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

**KAPACITETI INSTITUCIONAL 1**

Integritet dhe besim në njësinë  
monetare kombëtare

**KAPACITETI INSTITUCIONAL 4**

Të dhëna statistikore

**KAPACITETI INSTITUCIONAL 2**

Burimet njerëzore

**KAPACITETI INSTITUCIONAL 3**

Sistemi informativ

**KAPACITETI INSTITUCIONAL 5**

Veprimtaria hulumtuese

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

KI 1

KI 2

KI 3

KI 4

KI 5

### KAPACITETI INSTITUCIONAL 1 – Integritet dhe besim në njësinë monetare kombëtare

Banka Popullore si banka e vetme emetuese do të vazhdojë me aktivitetet e ruajtjes së integritetit dhe besimit në njësinë monetare kombëtare përmes funksionalitetit, stabilitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të vendosur në sistemin e furnizimit të parave të gatshme dhe sigurimin e cilësisë së lartë standarde të monedhave dhe kartëmonedhave në qarkullim.

#### AKTIVITETET KRYESORE:




Mbikëqyrja e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha te bankat dhe qendrat për para të gatshme



Furnizim dhe mbikëqyrje të furnizimit me kartëmonedha dhe monedha te bankat dhe qendrat për para të gatshme



Kryerjen e analizave eksperte dhe ekspertisë të parave të dyshueshme për zbulim preciz dhe efikas të parave të falsifikuara dhe ndalimin e prodhimit dhe distribuimit të falsifikateve



Rritje e efikasitetit operacional duke përmirësuar ekspertizën e monedhave me më shumë të dhëna

**Rezultatet e pritura:** Ruajtja e nivelit të lartë të integriteti dhe besimit në njësinë monetare kombëtare.

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

KI 1

KI 2

KI 3

KI 4

KI 5

### KAPACITETI INSTITUCIONAL 2 - Burimet njerëzore

Zhvillimi i vazhdueshëm i potencialit njerëzor modern dhe kompetent, i adaptueshëm me ndryshimet e shpejta në mjedis është parakusht për realizim efektiv dhe efikas të mandatit tonë të gjërë e kompleks dhe për përmbushjen e misionit tonë me interes më të gjërë publik. Punonjësit janë burimi më i madh i Bankës Popullore, prandaj do të vazhdojë të tregohet kujdes për tërheqjen, mbajtjen dhe motivimin e stafit të aftë dhe të përkushtuar. Gjithashtu, ne do të vazhdojmë me aktivitetet për të nxitur një mjedis pozitiv pune dhe kulturë korporative, si dhe për të zhvilluar bashkëpunimin, shpirtin ekipor dhe kreativitetin.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Sigurim dhe pranim të punonjësve, rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës



Krijimi i organizimit të përshtatshëm organizativ dhe sistematizimi



Zhvillim të aftësive udhëheqëse dhe drejtuese të udhëheqësve operacional dhe aftësive të buta midis punonjësve



Edukim të vazhdueshëm, përsosmëri profesionale, promovimin dhe zhvillimin e punonjësve, proces të vazhdueshëm për ruajtje dhe përmirësim të cilësisë së punës dhe arritjeve

#### Rezultatet e pritura:

Burimet njerëzore të kualifikuara, kompetente dhe të përkushtuara që mund të përshtaten shpejt me sfidat e jashtme gjithnjë në ndryshim janë thelbësore për arritjen e misionit dhe vizionit të Bankës Popullore dhe realizimin e qëllimeve të synuara. Respektimi i parimeve dhe cilësive të vendosura të organizatës, duke përfshirë: cilësinë, integritetin, besnikërinë, transparencën, leadershipin, inovacionin, fleksibilitetin, profesionalizmin dhe shpirtin ekipor.

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

KI 1

KI 2

KI 3

KI 4

KI 5

### KAPACITETI INSTITUCIONAL 3 – Sistemi informativ

Sistemi informativ i Bankës Popullore është sistem kompleks që përmban pajisje të ndryshme informative dhe komunikuese dhe numër të madh të të dhënave në formate të ndryshme, duke mbështetur proceset afariste në bankë gjatë kryerjes së aktiviteteve të ndryshme ditore dhe kritike. Për këtë arsye, Banka Popullore do të vazhdojë të sigurojë stabilitetin e këtij sistemi informativ dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij me harduerin dhe softuerin më të fundit në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, duke arritur shkallë të lartë të disponueshmërisë dhe sigurisë së informacionit në sistem.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës së TI-së



Menaxhimi me incidentet e TI-së



Prezantimi i SOC-it (Qendra e Operacioneve të Sigurisë të TI-së)



Testimi vjetor i rregullt i penetrimit dhe kontrollet e cënueshmërisë



Prezantimi i shërbimeve të TI-së së në re



Prezantimi i mjetit për ruajtjen e kodit burimor për bazat e të dhënave dhe një mjeti për testimin statik dhe dinamik dhe shërbimet për analizën mjekoligjore të incidenteve të TI-së



Zhvillimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve

#### Rezultatet e pritura:

Ruajtja e stabilitetit të sistemit informatik dhe përmirësimi i vazhdueshëm me harduer dhe softuer në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare të cilat do të mundësojnë shkallë të lartë të disponueshmërisë dhe siguri të të dhënave dhe infrastrukturës TI.

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

KI 1

KI 2

KI 3

KI 4

KI 5

### KAPACITETI INSTITUCIONAL 4 - Të dhëna statistikore

Të dhënat statistikore të mbledhura dhe të analizuar nga Banka Popullore janë të një rëndësie të madhe për mbarë publikun dhe luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e proceseve në Bankën Popullore në marrjen e vendimeve me kohë dhe cilësore. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe saktësisë së këtyre të dhënave, Banka Popullore do të vazhdojë të zhvillojë mundësitë për mbledhjen, analizën, përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Gjithashtu, Banka Popullore do të angazhohet plotësisht në përmbushjen e detyrimeve ndaj partnerëve ndërkombëtarë në fushën e statistikave dhe do të punojë për harmonizimin e të dhënave me standardet dhe praktikatat më të larta botërore.

#### AKTIVITETET KRYESORE:



Publikimi i të dhënave nga fusha e statistikës monetare dhe eksterne, statistika e llogarive financiare dhe letrave me vlerë, si dhe përmbushja e obligimeve të raportimit të cilat vijnë nga anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare



Aktivitetet për të pasuruar grupin e të dhënave statistikore të disponueshme për përdoruesit



Përmirësimi i bilancit të pagesave dhe MIP-së duke vendosur propozim-metodologji të re për transfertat private dhe para të gatshme në valutë jashtë sistemit bankar.



Racionalizimi i procesit të mbledhjes së të dhënave për investimet në dhe nga jashtë dhe aktivitetet kreditore me vendet e jashtme përmes implementimit të njoftimit elektronik

#### Rezultatet e pritura:

Përgatitja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore cilësore, në kohë dhe lehtësisht të qasshme të prodhuara në pajtueshmëri me standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, duke marrë në këtë mënyrë të dhëna në pajtueshmëri të krahasueshme me sistemet statistikore ndërkombëtare.

## KAPACITETE INSTITUCIONALE

KI 1

KI 2

KI 3

KI 4

KI 5


### KAPACITETI INSTITUCIONAL 5 - Veprimtaria hulumtuese

Banka Popullore do të vazhdojë me mbështetjen dhe promovimin e aktiviteteve të saj kërkimore dhe do të kontribuojë në promovimin dhe pasurimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit.


#### PËR SIGURIM TË HULUMTIMEVE CILËSORE DO TË PUNOHET NË:



Aktivitetet kërkimore janë pasqyruar në disa botime: raporte të rregullta, shtojca analitike brenda raporteve, materiale punuese, analiza, si dhe materiale të tjera



Organizimi i sesioneve të rregullta tremujore të Klubit të Hulumtuesve, si mundësi për të shkëmbyer përvoja me publikun në fushën e makroekonomisë dhe tema të tjera të operacioneve të bankës qendrore.



Materialet e punës:

- Avancimi i modelit të analizës së politikave në ekonominë e brendshme (MAKPAM);
- Çmimet e naftës dhe ushqimeve në Maqedoninë e Veriut: qasja jolineare ARDL



Investimi i vazhdueshëm në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kapacitetit analitik dhe hulumtues të punonjësve të vet

#### Rezultatet e pritura:

Inkurajimi i kërkimeve në fusha të ndryshme ekonomike dhe debati akademik për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në fushën e politikës monetare dhe stabilitetit financiar.



BANKA POPULLORE E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIU

---